

Fjalim i deputetit Eduard Shalsi

13.07.2023

– E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, më lejoni të falënderoj drejtoreshën e Institutit të Statistikave, sidomos punonjësit dhe ekipin e saj, me të cilët Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, që kam nderin të drejtoj, ka pasur vazhdimisht kontakte!

Për shembull, nëse zonja parafolëse do të kishte marrë mundimin t’u ishte bashkëngjitur deputetëve të Komisionit të Ekonomisë, aty kishte të djathtë dhe të majtë, do të kishte kuptuar se çfarë ndodh në atë institucion apo si funksionojnë këto institucione të pavarura.

Ka perënduar një herë e mirë koha kur Kryeministri dilte deklaronte rritjen ekonomike dhe të nesërmen dilte Instituti i Statistikave, apo kur ish-Kryeministri jepte shifra dhe pastaj Instituti i konfirmonte. Tashmë prej shumë kohësh kemi të bëjmë me një institucion të konsoliduar dhe, nëse do të kishit marrë mundimin të lexonit më shumë, të kuptonit më shumë, të diskutonit me punonjësit për sfidat që kanë, jam i bindur që sado pozicione partiake të verbra të donit të mbanit, përsëri nuk mund të flisnit jashtë realitetit, siç e bëni rëndom.

Ne si komision, e theksoj, si komision, sepse bashkë me deputetët që i përkasin opozitës, këtu fus të gjitha copëzat e opozitës, kemi pasur kontakte të vazhdueshme me Institutin e Statistikave, madje disa prej jush kanë qenë në vizitën që kemi bërë pranë institucionit, ku jemi informuar dhe kemi kuptuar akoma më shumë. Kemi nevojë të mësojmë. Nuk e kam problem ta pohoj se ka shumë gjëra që nuk i dimë dhe nuk i di, por nuk mund t’i kuptosh nëse nuk komunikon me specialistët. Titullarët e institucionit janë njerëz të përgatitur, profesionistë dhe njerëz me dinjitet, ku nuk mund t’u diktosh se çfarë duhet të prodhojnë apo çfarë duhet të thonë. Kini parasysh një gjë, ju kam këshilluar disa herë: jini të kujdesshëm kur flisni për institucione të tilla dhe për njerëzit pas këtyre institucioneve. A e dini pse?! Sepse ndoshta juve nuk ju bën përshtypje çfarë dëgjoni, çfarë thoni dhe çfarë nxirrni nga goja, por janë njerëz seriozë dhe unë e kuptova nga shqetësimi që kanë pasur disa herë, pas mbledhjeve që kemi zhvilluar në komision, kur i keni akuzuar për falsifikime.

Dëgjova një koleg tjetër të nderuar, i cili vendosi disa epitete aspak të denja, “fobi” apo “paragjykime”, tha zoti Dule. Në fakt, dua t’i them, sepse e kam ndjekur nga afër procesin edhe për shkak të funksionit: a je në dijeni të takimit të fundit që është bërë në qarkun e Gjirokastrës, ku ka qenë vetë titullarja bashkë me ekipin e saj? A je në dijeni të takimeve të vazhdueshme që disa ambasada, për shkak të shqetësimeve të tyre për minoritetet, kanë pasur me Institutin e Statistikave? A je në dijeni të diskutimeve, apo ke humbur kontaktet me ata njerëz dhe nuk e di që po zhvillohen konsulta? Për shembull, a e di që

Komisioni European po asiston procesin e censit qoftë të popullsisë dhe të banesave, qoftë edhe të bujqësisë? Po të thuash që nuk je në dijeni, atëherë të falet kjo padijeni, por nuk të falen ato lloj aludimesh që bëre.

Pra, Komisioni European po asiston procesin e censit, madje ka alokuar njerëz që merren me metodologjinë, merren me sektorin e teknologjisë së informacionit, merren edhe me sektorin e komunikimit. Po, është shumë e rëndësishme dhe biem dakord, që aspekti i komunikimit të censit është shumë i rëndësishëm. Mos i fryni skepticizmit, me të cilin me sa duket doni të mbani larg disa njerëz, nuk është e shëndetshme, nuk vlen. Metodologjia po asistohet nga një njeri me shumë eksperiencë që e ka sjellë Bashkimi European nga Holanda; sektori i teknologjisë së informacionit, nga një njeri me shumë eksperiencë, italian, ndërkohë për sektorin e komunikimit kemi një specialist gjerman. Pra, a e dini që në këtë proces është përfshirë dhe po jep asistencën teknike edhe Komisioni European, apo jo? Me sa duket, nuk e ditkeni. Nëse doni të flisni sa për të folur, në rregull. A e dini sa takime janë bërë nga komunitetet fetare? U çuditët: si ka mundësi që censi është shtyrë me 2 vjet! Po pandemia ku ishte?! Dikush tjetër foli e habitur për tabletat: si ka mundësi! Jo. A e dini që para dy vjetësh ndodhi pandemia, apo e keni harruar?!

Po jua kujtoj me përlësi që bota u përfshi nga një pandemi, ku nuk bëri përjashtim as Shqipëria dhe kjo ishte arsyeja. Po pse nxirrni...

Ju që po më pyesni tani, nuk jeni ju që e keni ngritur si shqetësim, sepse jam i bindur që jeni mjaftueshëm të arsyeshëm dhe të logjikshëm sa të mos ngrini pyetje të tilla paradoksale.

Pra, konsultat janë element i domosdoshëm i një censi të rëndësishëm. Po, është e vërtetë: ne kemi nevojë për të dhëna të besueshme, por ama gjatë gjithë këtyre viteve Instituti i Statistikave është një nga institucionet që meriton respekt, por nuk mund t'i bënte i vetëm, pa agjentët statistikorë si Ministria e Financave apo Banka e Shqipërisë.

Kam qenë, jam dhe do të mbetem i shqetësuar për të dhënat e bujqësisë. Nëse nuk e dini, aty nga fundi i vitit 2000, statistikave të bujqësisë u prodhuan në zyra pa lidhje me bujqësinë dhe që nga ajo kohë kemi probleme të mëdha me të dhënat. Unë jam një fanatik i të dhënave të sakta dhe shpeshherë qëllon që, ndoshta dëshira është e mirë, vullneti, por për shkak se vendimmarrja bazohet mbi të dhëna të gabuara, na ka çuar në disa vendime jo të drejta.

Bujqësia është një sektor, që sot e kësaj dite vuan nga mungesa adekuate e të dhënave. Më duhet ta pranoj që çalojmë shumë në këtë sektor dhe është një nga padurimet e mëdha që unë kam për të parë të dhëna reale për bujqësinë dhe kemi shumë për të bërë. Kjo ishte edhe arsyeja pse bujqësia u vendos si pjesë e censurit, por progresin në përmirësimin e të dhënave askush nuk mund ta mohojë. Pra, duam apo nuk duam, ne jemi bërë pjesë e raportimeve falë këtyre ndërkëmbimeve të shpeshta me Eurostat-in, me Komisionin European, çka pasqyrohet edhe në raport, çka pasqyrohet edhe gjatë diktimeve në kapitullin e 18-të, të cilat dëshmojnë se ka një progres të dukshëm. A duhet të bëjmë më shumë? Patjetër që duhet të bëjmë më shumë, vetëm se një kërkesë kam: larg politizimit të punës së këtyre institucioneve, sepse dëgjova me shumë vëmendje një koleg tjetër, i

cili i njohu meritën INSTAT-it, por aludoi dhe këshilloi me demek atë makthin e patronazhistëve. Mos ki merak, i nderuar, sepse edhe të duash të depërtosh me ide të tilla, aty ka njerëz profesionistë, mjaftueshëm të ndërgjegjshëm, të cilët nuk mund të bëhen pjesë.

Ndaj, të nderuar kolegë deputetë, është momenti që të bëhemi bashkë që të kërkojmë të dhëna më të shpejta, më të sakta, por për këtë gjë duhet t'i inkurajojmë këto institucione dhe jo t'i anatemojmë me të pavërteta që vijnë nga moskuptimësia, ajo çka do të dëshiroja të besoja, apo nga arsye të tjera, të cilat askush nuk i di më mirë sesa ju vetë.

Më lejoni t'ju them se brenda jush ka zëra racionalë, ka njerëz që unë i vlerësoj dhe i respektoj. Ndaj, dua ta falënderoj Institutin e Statistikave për punën dhe ta inkurajoj fort për këtë sfidë, pasi është një sfidë shumë e rëndësishme për të dhe për ne. Pra, ne duhet ta inkurajojmë këtë institucion dhe të mos e fusim në debate banale politike, që shpeshherë kanë molepsur këtë parlament.

Shumë faleminderit!